



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 3/2015

KUSHTET E PUNËS NË POLICINË KUFITARE DREJTORIA RAJONALE LINDJA- KAÇANIK



(KORRIK 2015)

Aprovuar
Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së

SHKURTESAT

DRPK	Drejtoria rajonale e policisë kufitare
DI	Departamenti i Inspektimeve
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
UA	Udhëzimi administrativ
TPK	Togu Patrullues Kufitar

P Ë R M B A J T J A

1.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4-4
2.	HYRJE.....	5-6
3.	PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE.....	7-7
	3.1 Vlerësimi i kushteve të punës sa i përket hapësirave të domosdoshme për punë si dhe pajisjeve logjistike.....	7-9
	3.2 Vlerësimi i respektimit të orarit të punës nga ana e zyrtarëve policor.....	9-11
4.	PËRFUNDIMET	12-12
5.	REKOMANDIMET.....	13-13
6.	PLANI I VEPRIMIT NË PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE.....	14-14

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1. Në bazë të nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), IPK-ja ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm në Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare "LINDJA" të Policinë e Kosovës (PK) lidhur me *"Kushtet e punës në Policinë Kufitare Drejtoria Rajonale Lindja - Kaçanik"*. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar kushtet e punës për kryerjen e detyrave të zyrtarëve policor si dhe respektimin e orarit të punës.

1.2. Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë, hartimi i programit inspektues duke përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjinë e punës. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më datë 16.03.2015 deri më 07.04. 2015 dhe zhvillohet në bazë të protokollit zyrtar të inspektimit, i cili përmban orarin dhe listën e intervistave.

1.3. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës në këtë fushë bëhet për të siguruar kushte më të mira për punë për zyrtarët policor, llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të veprimit në fuqi si dhe për ngritjen e performancës së zyrtarëve policor. Ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur.

1.4. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se kushtet e punës të cilat i ofrojnë objektet sa i përket hapësirave në të cilat punojnë zyrtarët policorë të Policisë Kufitare dallojnë nga njëri objekt te tjetri. Mirëpo, marrë në përgjithësi këto objekte i plotësojnë kushtet për kryerjen e detyrave nga zyrtarët policor. Të gjeturat e inspektimit gjithashtu tregojnë se kushtet e punës sa i përket mirëmbajtjes dhe pastërtisë në disa vendkalime kufitare nuk janë në nivelin e kënaqshëm.

1.5. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se kushtet e punës për zyrtarët policor të cilët punojnë në togjet patrulluese, me theks të veçantë zyrtarët të cilët qëndrojnë statik (24 orë në ditë) në kullat vrojtuese janë mjaft të papërshtatshme. Kullat vrojtuese janë të demoluara, pra i kanë xhamat e thyer, nuk ka hapësirë ku zyrtarët policor do të mundë të ushqeheshin, gjithashtu në afërsi të tyre nuk ka të ndërtuar hapësirë për nevoja fiziologjike (nuk ka tualet).

1.6. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se sa i përket kontrollit të vijueshmërisë në punë, në të gjitha stacionet policore të Policisë Kufitare Regjioni "Lindja", aplikohen listat e nënshkrimit për vijueshmërinë në punë. Mirëpo, të gjeturat e inspektimit gjithashtu tregojnë se jo në të gjitha stacionet policore këto lista nënshkruhen me rregull si në hyrje ashtu edhe në dalje nga orari i punës.

1.7. Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport IPK me datë 10.08.2015, ka dërguar draft raportin në DRPK "Lindja" për komente lidhur me të gjeturat e inspektimit. Me datë 12.08.2015 IPK nga DRPK "Lindja", ka pranuar komentet në të cilat paraqitet pajtueshmëria lidhur me të gjeturat e inspektimit. Komentet e DRPK "Lindja" janë të paraqitura në planin e veprimit për përmbushjen e rekomandimeve.

1. HYRJE

1.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, , neni 23 dhe neni 24 paragrafi 2, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të jashtëzakonshëm në Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare Regjioni LINDJA (*Kushtet e Punës në Policinë Kufitare Drejtoria Rajonale Lindja- Kaçanik*). Inspektimi është funksionalizuar nga data 16.03.2015 deri më 07.04. 2015.

1.2 Qëllimi i këtij inspektimi ishte:

- që të vlerësohen kushtet teknike të punës për zyrtarët policor të Policisë Kufitare Drejtoria Rajonale Lindja,
- që të vlerësohet respektimi i respektimit të orarit të punës nga zyrtarët policor të Policisë Kufitare Drejtoria Rajonale Lindja,
- të jepen rekomandime për sigurimin e mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të mjeteve.

1.3 Objekt i këtij inspektimi ishte vlerësimi i kushteve elementare për punë duke përfshirë hapësirat e nevojshme për ushqim, tualetet, si dhe mbështetja me pajisje logjistike. Gjithashtu objekt i inspektimit ka qenë edhe respektimi i orarit të punës nga ana e zyrtarëve policor. Inspektimi është fokusuar në Drejtorinë Rajonale Lindja të Policisë Kufitare duke përfshirë Pikë kalimet Kufitare, objektet ku janë të vendosura Togjet Patrulluese të vijës së gjelbër si dhe pikat statike të vendosura për mbikëqyrje të kufirit.

1.4 Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i kushteve të punës sa i përket hapësirave të domosdoshme për punë si dhe pajisjeve logjistike.
- Vlerësimi i respektimit të orarit të punës nga ana e zyrtarëve policor.

1.5 Periudha e mbulimit për këtë inspektim ka qenë, periudha kohore e zhvillimit të Inspektimit.

1.6 Inspektimi në këtë fushë luan rol të rëndësishëm dhe do të kontribuojë në:

- Ushtrimin e kontrollit për të siguruar një shkallë më të lartë të respektimit të orarit të punës.
- Ngritjen e efikasitetit në punë.
- Përmirësimin e kushteve të punës për zyrtarët policor.

1.7 Metodologjia: Gjatë këtij inspektimi është aplikuar metodologji e punës së kombinimit të intervistave me zyrtarët kompetent për fushën që inspektohet, kontrollimi fizik dhe marrja e dokumentacionit të shkruar relevant për periudhën që i kushtohet inspektimi.

1.8 Gjatë inspektimit, personeli i IPK-së ka intervistuar zyrtarët si në vijim

- Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare Rajoni LINDJA,
- Komandantët e Stacioneve Policore Kufitare (Pikë kalimet kufitare),
- Udhëheqësit e Togjeve Patrulluese të Vijës së Gjelbër,

- Zyrtar policorë (shembuj të rastit)

1.9 Inspektimi është përqendruar në këto fusha kryesore:

- Kushtet e punës në pikat kufitare DRP-Lindja,
- Respektimi i Orarit të Punës nga zyrtarët policor në DRP-Lindje si dhe pikat kufitare të kësaj drejtorie,
- Kushtet e punës sa i përket mbështetjes logjistike.

1.10 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës gjatë inspektimit ka marrë:

- Ligjin e Policisë së Kosovës;
- Ligjin e IPK-së;
- Udhëzimin Administrativ për Inspektime në PK-së;
- Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të PK-së;

2. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE

2.1. Vlerësimi i kushteve të punës sa i përket hapësirave të domosdoshme për punë si dhe pajisjeve logjistike

2.1.1 Inspektimi lidhur me kushtet e punës sa i përket hapësirave për punë, mbështetjes me pajisje logjistike si dhe respektimi i orarit të punës nga zyrtarët policor, ka filluar duke u bazuar në informacionet që ka poseduar IPK lidhur me këto çështje. Në këtë shkresë janë të përshkruara kushtet mjaft të rënda sa i përket hapësirave të punës me theks të veçantë mungesa e hapësirës së nevojshme për ushqim si dhe mungesës së tualeteve. Gjithashtu në këtë shkresë janë të paraqitura vështirësitë që paraqiten në kryerjes së detyrës zyrtare për shkak të mungesës së automjeteve të nevojshme për patrullim.

2.1.2 Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare Regjioni Lindja sipas strukturës organizative nën komandën e sajë ka katër vendkalime kufitare të cilat janë: Hani i Elezit, Gllobuqica, Dheu i Bardhë dhe Muqibaba. Gjithashtu në kuadër të kësaj drejtorie të Policisë Kufitare veprojnë edhe katër togje patrulluese të cilat janë të vendosura: në Hanë të Elezit, në Muqivërc, në Gjilan dhe në Zhegër.

2.1.3 IPK-ja ka inspektuar hapësirat e punës së zyrtarëve policor në të gjitha objektet me të cilat disponon DRP LINDJA, duke përfshirë objektin e Drejtorisë Rajonale, vendkalimet kufitare si dhe objektet ku janë të vendosura togjet Patrulluese. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se Drejtoria Rajonale është e vendosur në të njëjtin objekt në të cilin është i vendosur edhe Stacioni Policor i Kaçanikut. Ky objekt është trekatësh dhe është i ndërtuar me material të fortë, dhe në brendësinë e tij ka të gjitha hapësirat e nevojshme për punë. Vlen të theksohet se gjatë kohës së inspektimit hapësirat e këtij objekti ishin të mirëmbajtura mjaft mirë sa i përket çështjes së pastërtisë.

2.1.4 Sa i përket çështjes së objekteve në vendkalimet kufitare duhet theksuar se në dy nga katër vendkalimet kufitare (Hani i Elezit dhe Gllobuqica) objektet janë të ndërtuara me material të fortë kurse në dy vendkalimet tjera kufitare (Dheu i Bardhë dhe Muqibabë) objektet janë montazh (pra janë kontejner). Në dy objektet të cilat janë të ndërtuara me material të fortë kushtet për punë sa i përket hapësirave të nevojshme për punë janë mjaft të mira. Pra, posedojnë të gjitha hapësirat e nevojshme, duke filluar nga zyrat e punës e deri tek hapësira për përgatitjen e ushqimit. Mirëpo të njëjtën gjë nuk mundë ta themi edhe për dy objektet të cilat janë montazh, pasi që në këto objekte ka numër më të vogël të zyrave për punë, megjithëse edhe në këto objekte është e rezervuar nga një hapësirë e cila shfrytëzohet për ushqim.

2.1.5 Vlen të theksohet se në të gjitha objektet të cilat shfrytëzohen nga policia kufitare e Regjionit të Lindjes janë të ndara edhe hapësirat për banjo dhe tualete. Mirëpo gjithashtu vlen të theksohet se problem në vete sa i përket këtyre objekteve është çështja e pastërtisë, pasi që jo të gjitha vendkalimet kufitare kanë pastrues. Vendkalimet kufitare të cilat nuk kanë pastrues (Hani i Elezit dhe Gllobuqica), shërbehen me pastruesit të cilët janë në Drejtorinë Rajonale, ku një herë apo dy herë në javë shkojnë dhe i pastrojnë këto objekte.

Foto 1: Vendkalimi kufitar Hani i Elezit dhe



Foto 2. Objekti i togut patrullues Hani i Elezit



2.1.6 Ashtu siç e kemi potencuar edhe më lartë në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare Regjioni Lindja, përveç vendkalimeve kufitare në kuadër të kësaj Drejtorie veprojnë edhe katër togje patrulluese. Tri nga katër togjet patrulluese (në Hani i Elezit, në Muqiverc dhe në Zhegër) janë të vendosura në objekte të cilat janë të ndërtuara me material të fortë kurse një (në Gjilan) janë të vendosur në objekt montazh (pra kontejner). Objekti ku është i vendosur togu patrullues në Hani i Elezit ka hapësira të mjaftueshme për punë normale të zyrtarëve policor. Mirëpo të njëjtën gjë nuk mundë ta themi edhe për objektet tjera, pasi që kanë hapësira shumë më të vogla edhe pse këto objekte kanë hapësirat e domosdoshme për punë.

Foto 3. Objekti Gllobuqice



Foto 4. Objekti Hani i Elezit



2.1.7 Togjet patrulluese përveç patrullimeve të rregullta, aktivitetin e tyre e ushtrojnë edhe duke vendosur pika statike 24 orësh, si në pikat e vrojtimit ashtu edhe në rrugë të hapur. Mbajtja e pikave statike ka edhe sfidat e sajë pasi që në vendet ku mbahet pika statike nuk ka asnjë objekt apo hapësirë ku zyrtarët policor do të mundë të pushonin dhe të ushqehen. Gjithashtu në afërsi të këtyre pikave statike nuk ka as tualete, si një ndër kushtet më elementare për punë.

Foto 5. Pika vrojtuese afër Glllobuçices



Foto 6. Qeset me ushqim për zyrtaret policor



2.1.8 Sa i përket kushteve të punës së zyrtarëve policor në kullat vrojtuese, Inspektorët e IPK-se kanë vërejtur se kushtet janë mjaftë të vështira pasi që në këto kulla vrojtuese ishin të thyer të gjitha xhamat e kullës. Kur mbretëron mot i keq dhe me erë, atëherë mundë të konsiderojmë se qëndrimi i zyrtarëve policor në këto kulla vrojtuese është i pamundur për shkak të rrymimit të ajrit.

Foto 7. Pika vrojtuese afër Glllobuçices



Foto 8. Pika vrojtuese afër Glllobuçices



2.1.9 Përveç kushteve të punës si pjesë e objektivit të IPK-së, ka qen edhe mbështetja me pajisjet e nevojshme logjistike. Gjatë intervistave me menaxhmentin e Drejtorisë Rajonale Lindja të Policisë Kufitare duke përfshirë edhe menaxhmentin e vendkalimeve kufitare si dhe të togjeve patrulluese, Inspektorët kanë vërejtur se ky regjion i policisë kufitare është i pajisur në mënyrë të mjaftueshme me pajisjet e nevojshme logjistike. Pra, kanë edhe numër të mjaftueshëm të automjeteve për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të cilat i kanë para vete.

2.2 Vlerësimi i respektimit të orarit të punës nga ana e zyrtarëve policor

2.2.1 Me anë të Parimeve dhe Procedurave të PK-së, përcaktohet kohëzgjatja e orarit të punës, pushimet gjatë orarit të punës, puna jashtë orarit dhe puna në ndërrime, për të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe mënyra e funksionimit të punës me ndërrime¹. Orari i punës në Policinë e Kosovës është i organizuar në orar një, dy dhe tre ndërrimesh, pra varësisht nga natyra e punës së njësisë. Në ato njësi ku orari i punës organizohet në një dhe tre ndërrime, orari i punës zgjatë tetë (8) orë, duke llogaritur edhe një orë të pushimit. Kurse tek njësitë ku puna është e organizuar në dy ndërrime, orari i punës zgjatë dymbëdhjetë (12) orë.

2.2.2 Organizimi i punës në Policinë Kufitare të PK-së, është organizim i kombinuar me orarin një dhe dy ndërrimesh. Pra, këtu kemi personelin i cili punon vetëm në një ndërrim tetë (8) orësh që ndryshe quhet edhe orari administrativ i punës e që kryesisht në këtë ndërrim punojnë personeli (apo stafi) menaxherial dhe personeli administrativ. Kurse puna në dy ndërrime është e organizuar në Vendkalimet Kufitare si dhe në Togjet Patrulluese.

2.2.3 Ashtu siç ceket edhe në Parimin P-3.14, gjatë orarit të punës punonjësit e PK-së kanë të drejtën edhe të pushimit prej një ore. Punonjësit të cilët punojnë në orarin administrativ (prej orës 08:00 deri në ora 16:00), pushimin kanë të drejt ta shfrytëzojnë nga ora 12:00-13:00, kurse zyrtarët policor të cilët punojnë në ndërrime kohën e pushimit e rregullojnë dhe e përshtatin varësisht nga dinamika e punës, por duke përjashtuar mundësinë që ky pushim të shfrytëzohet në fillim dhe përfundim të orarit të punës.

2.2.4 IPK gjatë inspektimit në objektet e Policisë Kufitare të Drejtorisë Rajonale "Lindja", ka vërejtur se në të gjitha objektet qofshin ato të ndërtuara me material të fortë apo ato montazh (kontejner), kishte të ndarë një hapësirë (zyrë) e cila mundë të shfrytëzohej për përgatitjen e kafes apo çajit. Ndarja e hapësirave për përgatitjen e kafes ishte bërë me qëllim të shmangies së daljes së punonjësve të PK-së në restorante të ndryshme të qytetit (në objektet të cilat gjenden në qytete si në Gjilan dhe Kaçanik dhe në Vendkalimin kufitar Hani i Elezit), si dhe për ofrimin e kushteve sa ma të mira për punonjësit të cilët punojnë në vendkalimet tjera kufitare dhe në togjet patrulluese të vijës së gjelbër.

2.2.5 Me qëllim të kontrollit të vijueshmërisë në punë si dhe të respektimit të orarit të punës, në Drejtorinë Rajonale, Vendkalimet Kufitare si dhe në Togjet Patrulluese aplikohen listat e nënshkrimit të vijueshmërisë në punë për punonjësit. Në këto lista janë të paraqitura të dhënat: emri dhe mbiemri i punonjësit, numri i ID kartelës, nënshkrimi për kohën e hyrjes në punë dhe kohën e daljes nga puna.

2.2.6 IPK gjatë kontrollimit të listave të vijueshmërisë në punë ka vërejtur, se listat e vijueshmërisë në punë përgatiten ndaras varësisht nga organizimi i orarit të punës në ndërrime. Kjo dukuri ndodhë për arsye se në kuadër të vendkalimeve kufitare kemi orarin e punës të përzier, pasi që një pjesë e personelit punon vetëm në orarin administrativ tetë orësh, pra, nga ora 08:00-16:00, kurse pjesa tjetër e personelit punon në orarin dymbëdhjetë orësh.

2.2.7 Sa i përket aplikimit të listave të vijueshmërisë në punë për personelin i cili punon në orarin administrativ një ndërrimesh, Inspektorët kanë vërejtur se kjo listë respektohet nga i gjithë personeli. Pra, në listë nënshkruhen të gjithë duke përfshirë këtu Drejtorin Rajonal,

¹ Parimi P-3.14, Doracaku i Parimeve dhe i Procedurave

Komandantët e Vendkalimeve Kufitare si dhe të gjithë personelin tjetër. Gjatë kontrollimit të këtyre listave Inspektorët kanë vërejtur se në vendkalimin kufitar në Gllobuqicë lista e vijueshmërisë në punë nuk aplikohet fare për personelin i cili punon në orarin administrativ, gjë që për IPK-në është e pa pranueshme pasi që nuk ka mundësi që të kontrollohet vijueshmëria në punë dhe respektimi i orarit të punës.

2.2.8 Aplikimi i listave të vijueshmërisë në punë, gjithashtu respektohet në të gjitha vendkalimet kufitare si dhe në togjet patrulluese, ku personeli punon në orarin me dy ndërrime (pra me orarin dymbëdhjetë orësh). Në këto lista nënshkruhen i tërë personeli në kohën e fillimit të orarit të punës dhe në kohën e përfundimit të orarit të punës. Mirëpo vlen të theksohet, Inspektorët gjatë kontrollimit të listave kanë vërejtur se ka raste kur disa zyrtarë nuk e nënshkruajnë këtë listë në përfundim të orarit të punës megjithëse ishin të nënshkruar në fillim të orarit të punës, raste të tilla ka në shumicën e vendkalimeve kufitare dhe në togjet patrulluese.

2.2.9 Gjithashtu vlen të theksohet se Inspektorët kanë has në raste kur nënshkrimi i listave të vijueshmërisë në punë nuk janë nënshkruar nga disa zyrtarë as në fillim e as në përfundim të orarit të punës duke përfshirë këtu edhe udhëheqësin e ndërrimit edhe pse këta zyrtarë në orarin ditor të punës figurojnë se janë të caktuar në detyrë (“ndërrimi i ditës” 07:00-20:00 i datës 12.05.2015 TPK “D” Muqivërc). Përderisa në shumicën e vendkalimeve kufitare, Inspektorët kanë has në lista të cilat nuk ishin të nënshkruara në përfundim të orarit të punës, duhet theksuar se gjithashtu Inspektorët kanë has në raste kur rregulli i nënshkrimit të listave të vijueshmërisë në punë respektohej me përpikëri siç ishte rasti i vendkalimit Kufitar Hani i Elezit, Togu Patrullues në Gjilan dhe në Togun Patrullues në Hanin e Elezit.

2.2.10 Për IPK-në është mungesë fakti i mos respektimit apo mos plotësimit të listave të vijueshmërisë në punë, pasi që këto lista njëherit janë edhe dokument bindës për prezencën në punë dhe respektimin e orarit të punës nga ana e zyrtarëve policor. Vlen të theksohet se inspektorët gjatë inspektimit në teren nuk kanë has në ndonjë rast që zyrtarët policor gjatë orarit të punës ishin duke pirë kafe në ndonjë restaurant apo kafiteri.

2.2.11 Menaxhmenti nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Kufitare në bashkëpunim me menaxhmentin e Drejtorisë Rajonale “Lindja” kishin organizuar ekipe të përbashkëta të inspektimit. Qëllimi i këtyre inspektimeve ishte që të përcjellët nga afër zbatimin e planit operativ “Mbikëqyrja e Kufirit”, ngritja e motivimit të policëve në detyrë në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, ngritja e vigjilencës sidomos pas ngjarjeve të ndodhura në R. E Maqedonisë, bartja dhe përdorimi i pajisjeve personale si dhe siguria e vijës kufitare dhe objekteve të Policisë Kufitare. Njëkohësisht gjatë këtyre inspektimeve është kontrolluar edhe vijueshmëria në punë e zyrtarëve policor.

2.2.12 Gjatë kontrollimit dhe analizimit të raporteve të inspektimeve të kryera nga ana e menxhmentit të PK-së, Inspektorët nuk kanë has në ndonjë vërejtje e cila është potencuar në këto raporte. Mirëpo duhet theksuar se në asnjërin nga këto raporte të inspektimit nuk është trajtuar çështja e nënshkrimit të listave të vijueshmërisë së personelit në punë.

3. PËRFUNDIMET

3.1 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se kushtet e punës të cilat i ofrojnë objektet sa i përket hapësirave në të cilat punojnë zyrtarët policorë të Policisë Kufitare dallojnë nga njëri objekt te tjetri. Mirëpo, për dallim nga kushtet hapësinore të cilat i ofrojnë objektet policore, të gjeturat e inspektimit gjithashtu tregojnë se kushtet e punës sa i përket mirëmbajtjes dhe pastërtisë nuk janë në nivelin e kënaqshëm (sidomos në vendkalimin kufitar Hani i Elezit dhe Gllobuqicë) për arsye të mungesës së punëtorëve teknik të pastrimit. E papranueshme është kjo gjendje për faktin se në afërsi të vendkalimit kufitar Hani i Elezit është edhe fabrika e çimentos dhe se pluhuri i shkaktuar nga kjo fabrikë do të mundë të dëmtoj shëndetin e zyrtarëve policor të cilët punojnë në këtë vendkalim kufitar.

3.2 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se kushtet e punës për zyrtarët policor të cilët punojnë në togjet patrulluese, me theks të veçantë zyrtarët të cilët qëndrojnë statik (24 orë në ditë) në kullat vrojtuese janë mjaft të papërshtatshme. Kullat vrojtuese janë të demoluara, pra i kanë xhamat e thyer, nuk ka hapësirë ku zyrtarët policor do të mundë të ushqeheshin, gjithashtu në afërsi të tyre nuk ka të ndërtuar hapësirë për nevoja fiziologjike (nuk ka tualet).

3.3 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se sa i përket kontrollit të vijueshmërisë në punë, në të gjitha stacionet policore të Policisë Kufitare Regjioni "Lindja", aplikohen listat e nënshkrimit për vijueshmërinë në punë. Mirëpo, të gjeturat e inspektimit gjithashtu tregojnë se jo në të gjitha stacionet policore këto lista nënshkruhen me rregull si në hyrje ashtu edhe në dalje nga orari i punës.

4. REKOMANDIMET KRYESORE

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor si dhe në ngritjen e kushteve për punë për personelin policor të Policisë Kufitare Regjioni "Lindja", IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

1. *IPK rekomandon menaxhmentin e lartë të Policisë Kufitare që të angazhohet në sigurimin e personelit teknik në mënyrë që të mirëmbahen të pastërta objektet e PK-së duke ju siguruar ambient të pastër dhe të përshtatshëm për punë zyrtarëve policor.*
2. *IPK rekomandon menaxhmentin e lartë të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me Drejtorinë për menaxhimin e Objekteve të angazhohen në riparimin e kullave vrojtuese, duke ndërruar xhamat e kullës, improvizuar hapësirën për ushqim si dhe të sigurohen tualetet për nevojat e zyrtarëve policor.*
3. *IPK rekomandon Menaxhmentin e Drejtorisë Rajonale "Lindja" të PK-së, që të shtoj nivelin e kontrollit sa i përket çështjes së respektimit të orarit të punës me theks të veçantë nënshkrimin të listave të vijueshmërisë në punë. Gjithashtu IPK rekomandon Menaxhmentin e Departamentit të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve të shqyrtojë mundësit e aplikimit të sistemit elektronik të vijueshmërisë në punë.*

5 PLANI I VEPRIMIT I PK-se PER PERMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TE IPK-se

Nr	Rekomandimi i IPK-se	Komentet e PK-se
1	IPK rekomandon menaxhmentin e lartë të Policisë Kufitare që të angazhohet në sigurimin e personelit teknik në mënyrë që të mirëmbahen të pastërta objektet e PK-së duke ju siguruar ambient të pastër dhe të përshtatshëm për punë zyrtarëve policor.	Është siguruar personel i mjaftueshëm për mirëmbajtjen/Pastërtinë e Objekteve te SPK Hani Elezit dhe Gllloboqic.
2	IPK rekomandon menaxhmentin e lartë të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me Drejtorinë për menaxhimin e Objekteve të angazhohen në riparimin e kullave vrojtuese, duke ndërruar xhamat e kullës, improvizuar hapësirën për ushqim si dhe të sigurohen tualetet për nevojat e zyrtarëve policor.	Menaxhmenti i DRPK Lindje dhe menaxhmenti i SPK ka shtuar kontrollin e respektimit te orarit të punës dhe evidentimin e secilit punonjës në listat e pranim/ dorëzim të detyrës. Mbikëqyrësve ju janë dhanë rekomandime të qarta dhe do të jemi të përkushtuar në mbështetjen e zyrtareve policor me qëllim që bashkërisht të arrihen objektivat.
3	IPK rekomandon Menaxhmentin e Drejtorisë Rajonale "Lindja" të PK-së, që të shtoj nivelin e kontrollit sa i përket çështjes së respektimit të orarit të punës me theks të veçantë nënshkrimit të listave të vijueshmërisë në punë. Gjithashtu IPK rekomandon Menaxhmentin e Departamentit të Policisë Kufitare që në bashkëpunim me Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve të shqyrtojë mundësit e aplikimit të sistemit elektronik të vijueshmërisë në punë.	Nga ana e DRPK Lindje, janë bërë kërkesa për rregullimin e Kullave të Vëzhgimit. Kërkesa është e përcjellur deri ne zyrën e Prokurorimit dhe presim që së shpejti të realizohet.